

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT



E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

2013



Sami Kurteshi, Avokat i Popullit

Të nderuar qytetarë,

E drejta e qasjes në dokumente publike është e drejtë themelore në një shoqëri të lirë dhe demokratike dhe një nga treguesit e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike kundrejt qytetarëve, shoqërisë civile, mediave, etj.

Rrjedhja e lirë e informacionit luan rol të rëndësishëm në krijimin e besimit mes institucioneve publike dhe qytetarëve të vendit. Kjo gjithashtu rrit komunikimin brenda institucioneve publike, duke e bërë në këtë mënyrë administratën publike më efikase dhe më efektive në ofrimin e shërbimeve.

Për më tepër, qasja e lirë në informacion dhe dokumente publike mund të përdoret për të ushtruar të drejta të tjera thelbësore, që në mënyrë reciproke dhe njëkohësisht kushtëzojnë dhe forcojnë kurajon qytetare dhe shtetin e së drejtës.

Çështja e qasjes në dokumente publike është sfiduese në vazhdimësi. Ndryshimet strukturore e funksionale të institucioneve publike, çështja e sigurisë publike, mbrojtja e të dhënave personale, kohën e syrit global - internetit, çështje si privatizimi, korporatizimi, kontraktimi i projekteve të ndryshme publike etj. janë elemente që shtojnë jashtëzakonisht kompleksitetin e të drejtës për qasje në informata dhe dokumente publike.

Në parim gjithë dokumentet publike duhet të jenë të qasshme për publikun. Megjithatë, ka të dhëna publike dhe individuale që janë të mbrojtura, si përjashtime Por, sa herë të vlerësohen ose të përcaktohen përjashtimet kjo duhet të bëhet duke u bazuar në ligj.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) e obligon Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) jo vetëm t'u përgjigjet kërkesave për qasje në dokumente publike, por edhe t'i trajtojë ankesat për refuzim apo mospërgjigje të cilitdo institucion publik në kërkesa të tilla .

Ankesat që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, ashtu sikurse edhe ankesat për cilëndo shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, trajtohen nga IAP me paanësi, koonfidencialitet dhe profesionalizëm, parime këto mbi të cilat është themeluar dhe funksionon IAP, si institucion pavarur.

IAP inkurajon secilin individ që, përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, të bëhet pjesë e jetës publike në vend. Në këtë mënyrë, qytetarët, shoqëria civile, mediat etj. do të mund të bëhen pjesë e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme e forcimit të demokracisë, transparencës, llogaridhënies dhe ndërtimit të shtetit të së drejtës.

NORMAT NDËRKOMBËTARE PËR QASJE NË INFORMATA (PËR INFORMIM PUBLIK)

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

NENI 19

“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysht kufijtë.”

KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT

NENI 10 - Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysht kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

GARANCITË DHE NORMAT KOMBËTARE PËR INFORMIN NË KOSOVËS

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

NENI 40 [LIRIA E SHPREHJES]

1. *Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*
2. *Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*

NENI 41 [E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE]

1. *Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.*
2. *Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*

NENI 42 [LIRIA E MEDIAVE]

1. *Garantohet liria dhe pluralizmi i mediave.*
2. *Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet mediave, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*
3. *Çdokush ka të drejtë të korrigojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin*

KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS LIDHUR ME TË DREJTËN PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Në Republikën e Kosovës e drejta për qasje në dokumente publike është e garantuar me Kushtetutën e vendit dhe me një varg ligjesh dhe aktesh nënligjore që rregullojnë procedurat për realizimin e kësaj të drejte:

LIGJI NR. 03/L-215 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE (GAZETA ZYRTARE NR. 88, 25 NËNTOR 2010)

LIGJI NR. 03 / L-172 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE (GAZETA ZYRTARE NR. 70 / 31 MAJ 2010)

LIGJI NR. 03 / L-178 PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONEVE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË (GAZETA ZYRTARE NR. 76 / 10 GUSHT 2010)

LIGJI NR.03/L-195 PËR AVOKATIN E POPULLIT (GAZETA ZYRTARE, NR 80, 27 GUSHT 2010)

LIGJI NR. 02/L-28 PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE (GAZETA ZYRTARE, NR, 8, 01 JANAR. 2007)

LIGJI NR. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE (GAZETA ZYRTARE, NR. 82, 21. TETOR 2010)

LIGJI NR. 04/ L-184 PËR ADMINISTRIMIN E PUNËS NË ZYRË

LIGJI PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Ligji për qasje në dokumente publike garanton të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike dhe përcakton obligimet e institucioneve sa i përket kësaj çështjeje.

Ligji është i zbatueshëm nga qeveria dhe administrata në nivel qendror, rajonal dhe lokal, institucionet ligjvënëse dhe gjyqësore, personat fizik apo juridik që operojnë me fonde publike për të ushtruar funksione publike, si dhe institucionet e pavarura të themeluara sipas Kapitullit XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Dokument publik është çfarëdo dokumenti zyrtar, që shërben për të dëshmuar apo për të vërtetuar diçka, pa marrë parasysh formën fizike apo karakteristikat, tekstin e shkruar apo të shtypur, hartat, skemat, fotografitë, vizatimet, skicat, materialet punuese, si dhe inçizimet tingullore, të zëshme, magnetike apo elektronike, inçizimet optike apo videoinçizimet në çfarëdolloj forme, si dhe pajisje bartëse për përpunim automatik të të dhënave me memorie të instaluar apo bartëse për arkivimin e të dhënave në formë digjitale.

Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrihen në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike. Kërkesa i mundëson institucionit publik të identifikojë dokumentin e kërkuar, nga kushdo, kudo në botë. Kërkuesi i ndonjë dokumenti nuk është i obliguar që jap arsye për të pasur qasje në dokumente.

Kërkesat për qasje në dokumente publike duhet të trajtohen nga institucioni public brenda 7 ditësh prej kohës së regjistrimit të kërkesës. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesërishtëm, kërkuesi mundet që brenda 15 ditësh nga marrja e përgjigjes nga institucioni publik, të parashtrojë kërkesën për rishqyrtimin e çështjes duke kërkuar nga institucioni që të rishqyrtojë vendimin.

PËRGJEGJËSITË E IAP SIPAS LQDP

Ligji për Qasje në Dokumente Publike(LQDP) përcakton me dy nene të veçanta (Neni 10 dhe Neni 17 i LQDP-së) rolin e IAP-së lidhur me realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

NENI 10 - MOS PËRGJIGJA E INSTITUCIONIT PUBLIK

Refuzimi i kërkesës së kërkuarit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar, konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para IAP-së, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi.

NENI 17 - INSTITUCIONI AVOKATIT TË POPULLIT

1. Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar.

2. Detyrë e Institucionit të Avokatit të Popullit është që të kujdeset për realizimin e papengueshëm të së drejtës për qasje në dokumente publike, e sidomos

- 2.1. të ndërmarrë masat e nevojshme për të promovuar dhe përkarhur të drejtat themelore për qasje në dokumente, dhe*
- 2.2. t'ia paraqesë Kuvendit raportet e rregullta për zbatimin e së drejtës për qasje në dokumente zyrtare, nga institucionet publike.*

3. Institucioni i Avokatit të Popullit shërbimet për qytetarë i kryen pa pagesë.

4. Pala e pakënaqur në procedurën e realizimit të së drejtës në qasje në dokumente publike, mund t'i drejtohet me ankesë edhe institucioneve të tjera publike.

NYJE TË UEB FAQEVË TË INSTITUCIONEVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PORTALI SHTETËROR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS:

<http://www.rks-gov.net>

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS:

www.assembly-kosova.org

PRESIDENCA:

<http://www.president-ksgov.net>

ZYRA E KRYEMINISTRIT:

www.kryeministri-ks.net

MINISTRITË:

Ministrisë së Administratës Publike <http://map.rks-gov.net/>

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale <http://mpms.rks-gov.net>

Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik <http://mzhe.rks-gov.net>

Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor <http://mmpm.rks-gov.net/>

Ministrisë së Drejtësisë: <http://www.md-ks.org>

Ministrisë së Financave: <http://mf.rks-gov.net>

Ministrisë së Brendshme: <http://mpb-ks.org>

Ministrisë së Punëve të Jashtme: <http://www.mfa-ks.net>

Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës: <http://mksf-ks.org>

Ministrisë së Arsimit...: <http://www.masht-gov.net>

Ministrisë së Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve: <http://www.mkr-ks.org>

Ministrisë së Tregtisë dhe e Industrisë: <http://www.mti-ks.org>

Ministrisë së Shëndetësisë: <http://www.msh-ks.org>

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal: <http://mapl.rks-gov.net>

Ministrisë së Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor: <http://mmpm.rks-gov.net>

Ministrisë së Bujqësisë, ...: <http://www.mbpzhr-ks.net>

Ministrisë së për Komunitete dhe Kthim: <http://www.mkk-ks.org>

Ministrisë së Integrimi Evropiane: <http://mei-ks.net>

Ministrisë për Infrastrukturë: <http://mi-ks.net>

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

<http://gazetazyrtare.rks-gov.net>

POLICIA E KOSOVËS: <http://www.kosovopolice.com>

INSTITUTI POLICOR I KOSOVËS: <http://ipk.rks-gov.net>

AGJENCITË VARTËSE TË QEVERISË

Doganat e Kosovës <http://dogana.rks-gov.net>

Instituti i Kosovës për Administratë Publike <http://ikap.rks-gov.net>

Agjencia e Arkivave Shtetërore të Kosovës <http://ashak.rks-gov.net>

Trashëgimia Kulturore të Kosovës: <http://tkk.rks-gov.net>

Agjencia e Prokurimit Qendrorë të Kosovës: <http://aqp.rks-gov.net>

Agjencia e Statistikave të Kosovës: <http://esk.rks-gov.net>

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit: <http://mmpm.rks-gov.net/waterdata>

Agjencisë të Ushqimit dhe Veterinarisë: <http://www.auv-ks.net>

INSTITUCIONET E PAVARURA KUSHTETUESE

Institucioni I Avokatit të Popullit: <http://www.ombudspersonkosovo.org>

Zyra e Auditorit Gjeneral: <http://oag.rks-gov.net>

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve: <http://www.kqz-ks.org>

Banka Qendrore e Kosovës: <http://www.bqk-kos.org>

Komisioni i Pavarur për Media: <http://www.kpm-ks.org>

AGJENCITË E PAVARURA

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:
<http://www.amdp-rks.org>

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik: <http://krpp.rks-gov.net/>

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik: <http://oshp.rks-gov.net>

Paneli zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa: <http://pzap.rks-gov.net>

Komisioni i Konkurrencës së Republikës së Kosovës: <http://kkk.rks-gov.net>

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil: <http://kpmshc.rks-gov.net>

Autoriteti ??????? Civil i Kosovës: <http://www.caa-ks.org>

Agjencia Kundër Korrupsionit: <http://akk-ks.org>

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit: <http://www.art-ks.org>

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave: <http://www.arh-ks.org>

Instituti Gjyqësor i Kosovës: <http://igjk.rks-gov.net>

Këshilli Gjyqësor i Kosovës: <http://www.kgjk-ks.org>

Këshilli Prokurorial i Kosovës: <http://www.psh-ks.net>

Agjencia Kosovare e Privatizimit: <http://www.pak-ks.org>

Agjencia Kosovare të Pronës: <http://www.kpaonline.org>

Zyra Rregullative për Ujësjellës dhe Kanalizim e Kosovës:
<http://www.wvro-ks.org>

UEBFAQET E KOMUNAVE TE KOSOVËS :

<http://kk.rks-gov.net>

Shtojca I

KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Për: Njësinë/zyrtarin përgjegjës për komunikim me qytetarë të

(emri dhe adresa e institucionit)

I/e nderuar,

në pajtim me Ligjin për Qasje në dokumente publike kërkoj (të shoh origjinalin, të marrë kopjen në letër ose në formë elektronike) të dokumentit:

(PËRSHKRIMI I DOKUMENTIT)

Emri dhe mbiemri: _____

Adresa: _____

Nr. i tel: _____

e-mail: _____

Kontakti me Institucionin e Avokatit të Popullit

e-mail adresa:

info@ombudspersonkosovo.org

**Thirrjet falas për palët:
0800 15555**

Adresa e Zyrës Qendrore:
Institucioni i Avokatit të Popullit
Lagja Bregu i Diellit, Rr. “Enver Maloku”, nr. 28
10000 Prishtinë, KOSOVË

Puna me palë: e hënë – e premte, nga ora 08:30- 15:30

Tel: +381 (0) 38 223 782, +381 (0) 38 223 783,

+381 (0) 38 223 784, +381 (0) 38 223 789

Fax: +381 (0) 38 223 790

Zyra në Prizren

Adresa: Rr. “Remzi Ademi”, pn

Tel: +381 (0) 29 222 138

Puna me palë: 08:00 -16:00

Zyra në Pejë

Adresa: Rruga “Mbretëresha Teutë”

Nr.59, Kati III, Nr. 3,

Ndërtesa e Komunës

Tel: +381 (0) 39 432 931

Puna me palë: 08:00 -16:00

Zyra në Gjilan

Adresa: Rruga “Adem Jashari”

Ndërtesa e Komunës II

Tel: +381 (0) 280 320 843

Puna me palë: 08:00 -16:00

Zyra në Mitrovicë

Adresa: Sheshi “Agim Hajrizi”, pn,

Ndërtesa e Administ. Rajonale Tatimore

Tel: +381 (0)28 530 138

Puna me palë: 08:00 -16:00

Nën-zyra,Mitrovicë

Adresa: Rr. “Sami Frashëri” pn.

Lagja e Boshnjakëve,

Ndërtesa e ZAK në veri të Mitrovicës,

Tel: + 377 (0)45 455 319

+381 64- 956-00-50

Puna me palë: 08:00 -16:00

Zyra në Graçanicë

Telefoni : +381 (0) 38 65 118

Tel. mobil: + 377 (0) 44 367 719

+ 381 (0) 64 37 11 137

Puna me palë: 08:00 -16:00

Zyra në Ferizaj

Adresa: Ndërtesa e Komunës

Në përdhese

Tel.: +381 (0) 290 326 032

Puna me palë: 08:00 -16:00

Zyra në Gjakovë

Adresa: Rruga e UÇK-së, pn.

(përballë KRU “Radoniqi”)

Tel.: + 381 (0) 390 327 698

Puna me palë: 08:00 -16:00